

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Baumit Beteiligungen GmbH, me seli të regjistruar në adresën Wopfung 156, 2754 Waldegg, Republika e Austrisë, nëpërmjet avokatit Filip Zafirovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 22.04.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin Baumit Beteiligungen GmbH, me seli të regjistruar në adresën Wopfung 156, 2754 Waldegg, Republika e Austrisë, do të fitojë kontroll mbi MasterMas Sp. z o.o., me seli të regjistruar në rr. Józefa Piłsudskiego 55, Skawina, Republika e Polonisë, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 19.03.2026, si dhe të plotësuar më datë 25.03.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Baumit Beteiligungen GmbH, me seli të regjistruar në adresën Wopfung 156, 2754 Waldegg, Republika e Austrisë, me të cilin Baumit Beteiligungen GmbH do të fitojë kontroll të vetëm mbi MasterMas Sp. z o.o., me seli të regjistruar në rr. Józefa Piłsudskiego 55, Skawina, Republika e Polonisë, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me ekzaminimin e Njoftimit që nga dita e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcave të tyre, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

Baumit Beteiligungen GmbH është prodhues i materialeve të ndërtimit dhe furnizues i markave për bojëra, izolim, gips, sisteme rinovimi dhe sisteme dyshemeje, si nga llaçi i thatë ashtu edhe nga produktet në formë paste. Përveç kësaj, shoqëria është aktive në prodhimin e produkteve të tjera të ndërtimit, marketingun e këtyre produkteve, si dhe në transport dhe shpërndarje.

Baunit Beteiligungen GmbH është pjesë e Schmid Industrieholding GmbH, Austri. Schmid Industrieholding GmbH, Austri ka një shoqëri të varur të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime BAUMIT SHPKNJ Shkup, me adresë në Jadranska Magistrala nr. 165 Shkup – Butel, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe aktive në furnizimin me produkte të BAUMIT siç janë llaçet e thata, sistemet e fasadave, pllakat izoluese dhe sistemi i përbërë për izolim termik të jashtëm, përkatësisht me veprimtari prioritare 46.830 – tregti me shumicë e drurit, materialit ndërtimor dhe pajisjeve sanitare.

MasterMas Sp. z o.o. është një prodhues dhe furnizues polak i llaçeve me gati tridhjetë vjet përvojë në industri. Linjat e tij kryesore të prodhimit janë Klasik (Classic), Eko Linjë (Eco Line), Top Finishi (Top Finish), Premium dhe Konekt (Connect), si dhe astarët (primer-ët) shoqërues Universal dhe Super Acrylic.

MasterMas nuk ka persona juridikë të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e as nuk ka realizuar të hyra në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ